

VENDIM
Nr. 150, datë 22.3.2007

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË SË TRAJTIMIT
TË KONCESIONEVE (ATRAKO)

(Ndryshuar me VKM nr. 191, datë 13.3.2012)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 8 të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet” dhe të nenit 10 të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO), e cila kryen funksionet e njësisë së trajtimit të koncesioneve, sipas ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, për të nxitur dhe asistuar autoritetin kontraktues në vlerësimin dhe negocimin e koncesioneve.

2. Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO) është *institucion buxhetor*, në varësi të ministrit përgjegjës për ekonominë, me seli në Tiranë.

3. Kryetari i Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO) emërohet, lirohet ose shkarkohet nga ministri përgjegjës për ekonominë, sipas procedurave të përcaktuara në vendimin nr.173, datë 7.3.2003 të Këshillit të Ministrave “Për emërimin, lirimin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve, në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të Ministrit”.

4. Rregullat e brendshme për funksionimin e ATRAKO-s përcaktohen nga ministri përgjegjës për ekonominë.

5. Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO) ka këto kompetenca:

a) Ndhmon dhe këshillon autoritetet kontraktuese për:

i) shqyrtimin dhe vlerësimin e projekteve koncesionare, si propozime, të kërkuara apo të pakërkuara, veçanërisht për aspektet e rentabilitetit, fizibilitetit, besueshmërisë financiare të tyre dhe për kriterin e “vlerës për para”, sipas përkufizimit, që i është bërë këtij kriteri në ligjin nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”;

ii) hartimin e kërkesës për propozim, dokumenteve të parakualifikimit dhe të akteve të tjera, që kanë lidhje me garën (përfshirë projektkontratat koncesionare);

iii) vlerësimin e propozimeve;

iv) përcaktimin e ofertuesit më të mirë;

v) negocimet dhe nënshkrimin e kontratës së koncesionit.

b) Kontrakton ekspertë të specializuar në tregun vendas apo ndërkombëtar, në rast se gjykohet e nevojshme dhe me kërkesë të autoritetit kontraktues, për:

i) shqyrtimin, vlerësimin dhe realizimin e një projekti koncesionar;

ii) monitorimin e kontratave të koncesionit;

iii) dhënien e këshillave për çështje, që kanë të bëjnë me ndryshimet, shtesat apo rifinancimet e kontratave të koncesionit.

c) Merr pjesë dhe ndihmon në hartimin dhe unifikimin e dokumenteve standarde (përfshi dhe kontratat), si dhe të metodologjive për krahasimin e projekteve koncesionare.

ç) Organizon trajnimin e stafeve, që zbatojnë projekte koncesioni.

d) Promovon parimet, institucionale dhe ligjore, për nxitjen e përdorimit të praktikave më të mira ndërkombëtare në fushën e koncesioneve, për tërheqjen e investimeve të huaja.

dh) Nxiti zbatimin e praktikës më të mirë për procedurat dhe rregullat e koncesionit, veçanërisht për procedurën e propozimeve të pakërkua.

e) Përgatiti mendimin e saj për Këshillin e Ministrave, për kushtet e kontratës së koncesionit, si dhe për kriterin e “vlerës për para” në projektin e koncesionit, në përputhje me nenin 21/4 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”.

ë) Mban bazën e të dhënave (*data base*) për projektet koncesionare në shqyrtim, vlerësim apo ato në zbatim.

6. Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO) siguron të ardhura nga shërbimet, që kryen në dobi të autoritetit kontraktues, si dhe nga donatorë të ndryshëm.

7. *Shuma që do të paguhet për shërbimet e Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO), shpallet në dokumentet e garës dhe paguhet nga koncesionari fitues, si më poshtë vijon:*

a) Për projektet koncesionare deri në 5 000 000 (pesë milionë) euro, shuma e pagueshme është 5 000 (pesë mijë) euro.

b) Për projektet koncesionare mbi 5 000 000 (pesë milionë) euro deri në 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) euro, shuma e pagueshme është 10 000 (dhjetë mijë) euro.

c) Për projektet koncesionare mbi 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) euro deri në 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) euro, shuma e pagueshme është 20 000 (njëzet mijë) euro.

ç) Për projektet koncesionare mbi 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) euro, shuma e pagueshme është 30 000 (tridhjetë mijë) euro.

8. *Të ardhurat e përfituara sipas pikës 7 të këtij vendimi, derdhen në buxhetin e shtetit.*

9. *Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO), financohet nga buxheti i shtetit. Buxheti i ATRAKO-s miratohet me buxhetin e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si zë i veçantë.*

10. Marrëdhëniet e punës për punonjësit e Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO) rregullohen me “Kodin e Punës” dhe aktet e tjera, të nxjerra në zbatim të tij.

11. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha